



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government**

**Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister**

**Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance**

**Thirrje për përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (përfshirë rrjetet sektoriale) që veprojnë në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre në Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile .**

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12.02.2019 për aprovimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 02/04/2019 Nr.05/96, mbi themelimin e **Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile**<sup>1</sup>, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit me lehtësim të CiviKos hap thirrjen për përfaqësues të shoqërisë civile në **“Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile**

**Thirrja hapet për:**

- 10 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë;
- 4 përfaqësues të Rrjeteve Tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile që veprojnë në Kosovë;

**THIRRJA ËSHTË E HAPUR PËR TË GJITHA ORGANIZATAT, PAVARËSISHT NËSE JANË ANËTARE TË PLATFORMËS CIVKOS OSE JO.**

**KRITERET PËR NOMINIM**

**OJQ-të ose Rrjetet tematike duhet ti plotësojnë këto kritere:**

**PËR OJQ-të**

- Të jenë të regjistruar në Kosovë si OJQ;
- Të jenë aktiv së paku gjatë tre viteve të fundit;
- Të dëshmojnë angazhimin e tyre në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

**PËR RRJETET TEMATIKE**

---

<sup>1</sup> <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/04/Vendimet-e-mbledhjes-96-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-1.pdf>

- Të jenë aktiv si rrjet i organizatave në një sektor të caktuar;
- Të kenë së paku 10 organizata të shoqërisë civile anëtare të rrjetit;
- Të dëshmojnë përvojë të funksionimit të rrjetit për së paku tre vitet e fundit;
- Të dëshmojnë angazhimin e tyre dhe/ose organizatave anëtare në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

#### **KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KËTO KUSHTE**

- Përvojë së paku tri vite në organizatë/rrjet të organizatave; ((përvoja duhet të jetë në organizatën/rrjetin nominues ose në një organizatë/rrjet të ngjashëm)
- Përkushtim në promovimin e parimeve të bashkëpunimit ndër-sektorial të hapur, transparent dhe të strukturuar.

#### **DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR NOMINIM**

##### **Për të nominuar përfaqësuesit e tyre OJQ-të duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;
- Formularin e plotësuar;
- Cv-në e kandidatit/es së nominuar nga organizata.

##### **Rrjetet tematike të OSHC-ve duhet të dorëzojnë këto dokumente**

- Një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së rrjetit, ku dëshmon veprimtarinë e rrjetit për tri vitet e fundit;
- Statutin dhe certifikatën e regjistrimit të OJQ-së (nëse është rrjet i regjistruar);
- Listën e organizatave anëtarëve, me kontakte;
- CV- në e kandidatit/es së nominuar nga rrjeti.

#### **KUFIZIMET NË PROCESIN E NOMINIMEVE**

- Një (1) OJQ apo rrjet tematik mund të nominojë vetëm një kandidat.

#### **ANGAZHIMI NË KËSHILL ËSHTË PA KOMPENZIM FINANCIAR**

#### **PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE PROCEDURA E VOTIMIT**

OSHC-të (OJQ-të dhe rrjetet tematike) të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar duhet të plotësojnë kriteret bazë, siç janë të përcaktuara në Formularin për Nominim.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos-it dhe një përfaqësues i Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM) do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

### **Lista e votimit do të jetë e ndarë në dy grupe:**

1. Lista e përfaqësuesve të OJQ-ve, dhe:
2. Lista e përfaqësuesve të rrjeteve tematike.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos dhe ZQM/ZKM do të njoftojnë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OShC-të e regjistruara si OJQ në Kosovë mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit.

### **Limitimet në votim**

**Nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim, secila organizatë mund të votojë për 2 kandidatë për përfaqësues të OJQ-ve dhe 2 kandidatë nga rrjetet tematike.**

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail në [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), postë të rregullt, ose personalisht në zyrën e CiviKos ( Adresa: Rruga Bedri Pejani 7/A 1000 Prishtinë. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos-it.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos, dhe përfaqësues të ZQM. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave.

**4 përfaqësuesit e rrjeteve tematike dhe 10 përfaqësuesit e OJQ-ve që marrin më së shumti vota përzqjedhen si anëtarë të Këshillit. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.**

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve të gjitha OJQ-të-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe të interesuar të tjerë.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nën-përfaqësuar.

Në rast të tërheqjes apo dështimit të pranimit të mandatit nga ndonjë përfaqësues i zgjedhur nëpërmjet këtij procesi në një periudhë prej 12 muajsh nga data e përfundimit të këtij procesi, kandidatët e ranguar më së larti në mesin e kandidatëve që nuk arrijnë të fitojnë numrin e mjaftueshëm të votave do të ftohen për të zëvendësuar kandidatin/en e tërhequr.

**Afati për nominim është nga data 11.04.2019 deri më 30.04.2019**

Nominimin tuaj ( me te gjitha dokumentet e kërkuara) mund ta dërgoni përmes email ne [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net), ose tek zyret e CiviKos adresa: Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net) ose numrit të telefonit 038 224 904.